

RAPORTI VJETOR 2024

Sigal Uniqa Invest sha

- **Fondi I Pensionit Privat SIGAL**
- **Fondi I Pensionit Privat SIGAL PRO**
- **Fondi I Investimit SIGAL INVEST**

Raporti vjetor nuk është një ofertë ose reklamë për fondet e Pensionit apo Fondin e Investimit SIGAL Uniqa Invest sha.

Ky raport përmban pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe secilit prej fondeve që ajo administron për vitin 2024, të audituara nga shoqëria PricewaterhouseCoopers Assurance Services sh.p.k.

PËRMBAJTJA

- Sigal Uniqa Invest sha
- Rreth nesh
- Misioni
- Vizioni
- Vlerat dhe premtimi ynë
- Organet drejtuese
- Transparenca
- Investimet
- Performanca e Fondeve deri më 31.12.2024
- Historiku Tarifës Adminisitrative
- Fondi i Pensionit SIGAL
- Performanca e Fondit
- Strategjia e Investimit
- Fondi i Pensionit SIGAL PRO
- Performanca e Fondit
- Strategjia e Investimit
- Fondi i Investimit SIGAL INVEST
- Performanca e Fondit
- Strategjia e Investimit

SIGAL UNIQA INVEST – Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. është person juridik i themeluar më 21.01.2006 dhe i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 31.01.2006 me NUIS – K61423001P, me seli në Rr. “Ukraina e Lirë”, pas Kullave Binjake, midis Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë, me licencë nr. 2, datë 28.04.2022 lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përfaqësuar nga Z. ELVIS PONARI, Administrator.

Shoqëria Administruese ka si objekt të aktivitetit të saj veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat dhe të aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën nr. 2, datë 28.04.2022, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria administruese ka nën administrim:

- Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL – Fond Pensioni Privat me Pjesëmarrje të Hapur, licencuar me vendim nr. 51 datë 30.03.2011 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO – Fond Pensioni Privat me Pjesëmarrje të Hapur, licencuar me vendim nr. 251 dhe datë 20.12.2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- Fondin e Investimit me Pjesëmarrje të Hapur me Ofertë Publike – **SIGAL INVEST** licencuar me vendim nr. 17 datë 28.02.2023 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Misioni ynë është të ndihmojmë njerëzit që investimet e përditshme, sado të vogla, t’i kthejnë në ëndrrat e tyre, sado të mëdha. Ne punojmë me përgjegjësi sociale për një biznes që të rritet vazhdimisht dhe që kontribuon për një jetë cilësore për punonjësit tanë, partnerët dhe komunitetin tone. Qëllimi ynë është që ti sigurojmë të gjithë anëtarëve të fondeve SIGAL, mundësinë e një pensioni të përshtatshëm për të ruajtur standartin e jetesës sipas kërkesave, nevojave dhe pritshmërove të tyre, duke maximizuar përfitimet nëpërmjet administrimit të kujdesshëm të aseteve.

Vizioni ynë është të punojmë për suksesin dhe fuqizimin e pozitave tona financiare rajonale, duke u fokusuar në ruajtjen dhe forcimin e mëtejshëm të pozicionit tone në treg përmes qëndrueshmërisë financiare, produkteve dhe shërbimeve cilësore, profesionalizmit dhe transparencës përtë gjithë anëtarët tanë.

Vlerat tona

- ✓ Klienti është në qendër të vëmëndjes
- ✓ Respekt, përkujdesje, mirënjohje, tolerance dhe dëgjim aktiv
- ✓ Disiplinë, vetkontroll, sjellje model
- ✓ Entuziazëm, gadishmëri dhe punë me pasion dhe dashuri
- ✓ Kreativitet

- ✓ Integritet, përgjegjshmëri, sinqeritet dhe mbajtje e fjalës së dhënë
- ✓ Ambicie për progress, këmbëngulje, optimizëm dhe Qëndrim pozitiv
- ✓ Angazhim për exelencë dhe përmirësim I vazhdueshëm në çdo gjë që bëjmë.

Premtimi ynë është të punojmë sëbashku duke u bazuar në misionin dhe vlerat tona për të krijuar Deklaratën e premtimit e cila shpreh atë çfarë anëtarët presin prej nesh:

Ne do të:

- ✓ Jemi pranë jush për tju siguruar nivelin më të lartë të shërbimit.
- ✓ Veprojmë në interesin tuaj më të mirë dhe administrojmë investimet dhe pagesat e pensionit me profesionalizëm.
- ✓ Sigurojmë informacion të saktë në kohën e duhur dhe në menyrë konfidenciale.
- ✓ Kemi stafin dhe strategjinë e duhur për të administruar më mirë pensionin tuaj .
- ✓ Përfaqësojmë dhe mbrojmë interesat tuaja duke u siguruar që zëri juaj të dëgjohej.

Organet Drejtuese të Shoqërisë Administruese janë:

I. Asambleja e Aksionarëve

Asambleja e Aksionarëve përbëhet nga këta përfaqësues ligjorë të shoqërisë:

1. Edvin Hoxhaj, Shoqëria “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a.

2. Avni Ponari, CEO SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.

II. Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë:

1. Adrian	Totokoçi	Kryetar
2. Abdyl	Sarja	Anëtar
3. Edvin	Hoxhaj	Anëtar
4. Klement	Mersini	Anëtar
5. Elvis	Ponari	Anëtar

Këshilli i Administrimit ka kompetencë kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese, miraton politikat financiare dhe politikat e investimit, emëron dhe shkarkon administratorët ose anëtarët e komitetit të investimit. Këshilli i Administrimit angazhohet që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit.

Z. Adrian Totokoci, vjen nga një eksperiencë e gjatë në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë, me përvojë në pozicione drejtuese në institucione shtetërore të tregtisë së jashtme.



Z. Totokoçi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1980-1985). Z. Totokoçi ka kryer studime pasuniversitare në Universitetin e Manhattan-it (1992-1993) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aktualisht ai është:

- Administrator i Përgjithshëm, Kompania ALTO Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Toyota në Shqipëri.
- Administrator i Përgjithshëm, Kompania AVEL Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Peugeot në Shqipëri,
- Anëtar Bordi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Japoni.

Z. Abdyl Sarja, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Juridik të shoqërisë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. ka një përvojë të mirë të vendosjes së standardeve organizative e ligjore të shoqërisë.



Z. Sarja prej vitit 2013 është Sekretar i Përgjithshëm i “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a.

Ai është diplomuar si Jurist në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (1996-2000). Z. Sarja ka titullin master në Të Drejtat Evropiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Francë (2003-2004) dhe Titulli i Avokatit (që nga viti 2005). Gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pas diplomimit, Z. Sarja ka punuar si Avokat Specialist pranë Këshillit të Qarkut, Tiranë (2000-2002); si Specialist në Sektorin Juridik në Departamentin e Mbështetjes Profesionale; (2002-2004), si Përgjegjës i Sektorit Juridik (2004-2005) dhe në fund si Drejtor i Drejtorisë Ligjore dhe

Licencimit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (sot Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) (2005-2006).

Z. Sarja është anëtar bordi i SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.Kosovë (që nga viti 2008) dhe Kryetar i Komitetit Ligjor të Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë. Ai ka shërbyer edhe për dy mandate si Anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Z. Abdyl Sarja nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Z.Edvin Hoxhaj, Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. me një eksperiencë të pasur në fushën e sigurimeve në përgjithësi dhe atë të jetës e risigurimeve në veçanti.



Z. Edvin Hoxhaj është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1984-1988). Ai ka ndjekur Studime Postuniversitare për Vlerësimet e Pasurive të Paluajtshme në Universitetin Politeknik, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, në vitet 1993-1994.

Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht mbi Sigurimet (Jo Jetë dhe Jetë) dhe Risigurime si dhe për Menaxhim Biznesi.

Z. Hoxhaj e filloi karrierën e tij në industrinë e sigurimeve duke punuar në Institutin e Sigurimeve të Shqipërisë në Korrik 1992, ku ka mbajtur disa pozicione: Menaxheri i Zyrës së Sigurimit të Pronës (1992-1996); Drejtor i Departamentit Motorik (1996-1998) dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës (1997-1999). Nisur nga përgatitja e plotë dhe përvoja e tij e gjatë, Z. Hoxhaj është kontribues në disa subjekte në tregun e sigurimeve në vend dhe në Ballkan.

Aktualisht është anëtar bordi i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. (që nga viti 2008); anëtar i Bordit Këshillimor të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a., Kosovë (që nga viti 2012) dhe anëtar i Bordit Këshillimor të UNIQA Life a.d. Shkup (që nga viti 2014) Maqedonia e Veriut.

Z. Edvin Hoxhaj nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Z.Klement Mersini ka një formim e eksperiencë të pasur në fushën financiare.



Aktualisht, Z.Mersini mban postin e Drejtorit të Departamentit Financiar në kompaninë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.

Z. Mersini është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në degën Financë – Kontabilitet (1994-1998), ndërsa ka vijuar studimet pasuniversitare dhe aktualisht është kandidat për PhD. Z. Mersini është Kontabël i Miratuar (që nga viti 2002) dhe Ekspert Kontabël i Autorizuar (që nga viti 2010). Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht për mbikëqyrjen dhe raportimet në shoqëritë e sigurimit, menaxhimin e rrezikut, menaxhimin e aktiveve, Solvency 2, IFRS 4, IFRS 17, etj.

Z. Klement Mersini nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Z.Elvis Ponari është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “SIGAL Life UNIQA Group Austria” sh.a..



Z. Ponari është inxhinier financiar me arsim pasuniversitar, zotëron master në Administrim Biznesi (MBA) në banka dhe sigurime dhe master shkencor (MSc) në Financë. Me një eksperiencë 10 vjeçare në sigurime në Vjenë, Austri, ku ka mbajtur pozicionin si Drejtor Rajonal në UNIQA Group Austria. Gjithashtu, Z. Elvis Ponari ka dhe një eksperiencë 3 vjeçare si drejtues në Bankën e Shqipërisë dhe më pas në rolin Drejtues Ligjor i kompanisë vendase ALBGAS. Aktualisht, është dhe anëtar bordi tek SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. në Kosovë.

Përpos ekspertizës, Z. Elvis Ponari ka qenë lektor në trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të rrezikut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit në universitete dhe në institucione financiare vendase dhe të huaja.

Z. Elvis Ponari, nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Transparenca

Shoqëria Administruese siguron një transparencë të vazhdueshme për anëtarët e fondit duke i informuar për situatën e aktiveve të tyre nëpërmjet:

a) Sistemit duke mundësuar kontroll 24 orë në llogaritë individuale të anëtarëve në faqen e internetit www.fondisigal.com.al, ku anëtarët me mjete elektronike të informohen në çdo kohë duke aksesuar llogarinë individuale për aktivet përfshirë vlerësimin e vlerës neto të aktiveve, totalin e ndryshimit të aktiveve për periudhën 12 -muajore, normën e kthimit nga investimi për fondin për periudhën 12-mujore, kthimin nga investimi, që nga fillimi i pjesëmarrjes në fond, datat e kontributeve dhe transferimet e aktiveve të bëra nga ose në emër të anëtarit gjatë periudhës përkatëse.

b) Shoqëria administruese harton një dokumentin “Vërtetim për gjendjen e llogarisë së pensionit të anëtarit të fondit.” për gjendjen e llogarisë së pensionit për çdo anëtar të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL MAX PENSION. Vërtetimi i vihet në dispozicion çdo anëtar, pa pagesë, në formë elektronike, të paktën 1 (një) herë në vit. Krahas çdo informacioni në formë elektronike, anëtarëve u jepet edhe një kopje fizike me kërkesë të tyre.

Shoqëria administruese publikon vlerën neto të aktiveve dhe vlerën neto të kuotës së fondit në ditën e vlerësimit. Prospektin, raportet financiare të ndërmjetme (çdo 3-muaj), raportin vjetor të audituar (1herë/vit) ose botime të tjera të publikuara nga shoqëria administruese. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë administruese. Krahas çdo informacioni në formë elektronike, anëtarëve u jepet edhe një kopje fizike me kërkesë të tyre.

Shoqëria Adminsitruese është gjithashtu në komunikim të vazhdueshëm me anëtarët si nëpërmjet e-mail apo telefonatave duke i sqaruar çdo pyetje apo kërkesë që lidhet me investimin e tyre.

Investimet


Objektivi i investimit të fondeve që Shoqëria Adminsitruese Adminsitron është:

- Investimi në tituj të Qeverisë shqiptare me afat të gjatë gjë e cila maksimizon kthimin afatgjatë të investimit.
- Investimi në tituj të Qeverisë Shqiptare e cila siguron normë më të lartë kthimi dhe maksimizim të fitimit të Fondit të Pensionit.
- Administrim i kujdesshëm dhe konservator i rrezikut të investimit. Për këtë arsye objektivi i investimit është investimi në instrumente financiare me rrezik sa më të ulët.
- Portofoli i investimeve do të ndërtohet nga obligacione afatgjatë të emetuara dhe garantuara nga Republika e Shqipërisë me synimin e maksimizimit të fitimit të kushtëzuar nga kufijtë e rrezikut dhe likuiditetit.

Performanca e Fondeve më 31.12.2024

Kthimi neto nga investimi	Fondi I Pensionit SIGAL	Fondi i Pensionit SIGAL PRO	Fondi i Investimit SIGAL INVEST
31.12.2023 - 31.12.2024	4.16%	2.69%	6.87%

Kthimi nga investimi i fondeve që shoqëria Adminsitruese ka nën administrim të saj kanë një rritje të kthimit nga investimi me ritme mjaft të shpejta dhe kjo falë një strategjie të menaxhimit efikas bazuar në analiza dhe vendimarrje të orientuar drejt performancës afatgjatë.



Historiku Tarifës Adminsitrativë

Viti	2011 - 2019	2020	2021-2023	2024	2025
Tarifa e Administrimit	3.00%	2.50%	2.20%	1.50% & 2.20%	1.50%

Shoqëria administruese për t'ju përmbajtur sa më mirë misionit, vizionit dhe vlerave të saj ka rishikuar në vazhdimësi tarifën e adminsitritimit duke e ulur atë në mënyrë të ndjeshme.

Tarifa më 31.12.2024 ka qënë 1.50%. Ky veprim është bërë që shoqëria ti përmbahet premtimit të saj për të qënë sa më pranë investitorëve për ti siguruar atyre një kthim më të lartë.

Fondi i Pensionit SIGAL

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL MAX PENSION - është aktualisht fondi më i madh në tregun e Pensioneve private në Shqipëri me rreth 38.87% të këtij tregu dhe me një vlerë asetesh 3,151,462,918 lekë. Aktivët e Fondit janë tërësisht të ndara prej aktiveve të tjera të administruara nga Shoqëria Administruuese dhe nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të Shoqërisë Administruuese.

Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Dhjetor 2024

Vlera Neto e Aseteve	3,151,462,918.26 Lekë
Numri i anëtarëve	14,914
Çmimi i Kuotës	1,722.2878 Lekë
*Fitimi vjetor (31/12/23-31/12/2024)	4.16 %

Fondi i Pensionit SIGAL ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit. Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Strategjia e investimit

Të gjitha investimet kryhen në mënyrë të matur dhe të përgjegjshme duke mbajtur parasysh ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe të një niveli të mjaftueshëm likuiditeti, për të përmbushur të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme në momentin që këto të fundit bëhen të pagueshme.

Fondi investoi gjatë vitit 2024 kryesisht në obligacione afatgjatë të shtetit shqiptar me afate 10 dhe 15 vjeçare për shkak të kohës së largët të daljes në pension si dhe për shkak të maksimizimit të fitimit për anëtarët e fondit.

Në 31 dhjetor 2024 struktura e portofolit të investimeve të Fondit të Pensionit Privat SIGAL paraqitet si më poshtë:

Instrumenti	Vlera në Lekë	Përqindja e asetëve
Tituj të Qeverisë Shqiptare (Obligacione)	3,120,562,550.39	98.83%
Mjete monetare (Llogari rrjedhëse)	36,928,963.29	1.17%

Performanca

Aktivet e Fondit të pensionit SIGAL më 31.12.2024 arritën vlerën 3,151,462,918 lekë me një rritje prej 13.26% krahasuar me vitin 2023.

Numri i anëtarëve të fondit është rritur me 32.64% krahasuar me vitin paraardhës, gjë që tregon rritje të interesit dhe të besimit të individëve ndaj Fondit të Pensionit SIGAL.

Kthimi nga Investimi për vitin e fundit 31.12.2023-31.12.2024 ka qënë 4.16% nga 3.52% për vitin 31.12.2022-31.12.2023.

Kjo rritje tregon se Fondi po performon mjaft mire dhe investimet janë rritur ndjeshëm.

Fondi I Pensionit SIGAL PRO

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL PRO PENSION** është miratuar me vendim nr. 251 datë 20.12.2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. SIGAL UNIQA INVEST - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a është licencuar me vendim nr. 50 datë 30.03.2011 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrim të aktivitetit në tregun e fondeve të pensionit vullnetar dhe me vendim nr. 95, datë 28.04.2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrim të aktivitetit në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Ky Fond ka nisur aktivitetin e tij në datën 02.11.2023 dhe operon në monedhën vendase, në Lekë.

Fondi i Pensionit SIGAL PRO ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit. Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Dhjetor 2024

Vlera Neto e Aseteve	20,239,181.13 Lekë
Numri i anëtarëve	545
Çmimi i Kuotës	1,023.1772 Lekë
*Fitimi(31/12/2023-31/12/2024)	2.69%

Strategjia e investimit

Të gjitha investimet kryhen në mënyrë të matur dhe të përgjegjshme duke mbajtur parasysh ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe të një niveli të mjaftueshëm likuiditeti, për të përmbushur të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme në momentin që këto të fundit bëhen të pagueshme.

Fondi investoi gjatë vitit 2024 kryesisht në obligacione afatgjatë të shtetit shqiptar me afate 10 dhe 15 vjeçare për shkak të kohës së largët të daljes në pension si dhe për shkak të maksimizimit të fitimit për anëtarët e fondit.

Në 31 dhjetor 2024 struktura e portofolit të investimeve të Fondit të Pensionit Privat SIGAL PRO paraqitet si më poshtë:

Instrumenti	Vlera në lekë	Përqindja e aseteve
Tituj të Qeverisë Shqiptare (Obligacione)	19,845,929.29	97.95%
Mjete monetare (Llogari rrjedhëse)	414,735.32	2.05%

Performanca

Fondi I Pensionit SIGAL PRO është një fond I ri I cili e nisi aktivitetin e tij në nëntor të vitit 2023. Aktiviteti i Fondit të pensionit SIGAL Pro më 31.12.2024 arritën vlerën 20,239,181.35 lekë.

Strategjia e përdorur gjatë vitit 2024 ka bërë që numri i anëtarëve dhe kontributet në fond të rriten nga muaji në muaj. Rritja e kontributeve në fond lehtëson procesin e menaxhimit të likuiditetit me qëllim që fondit të ketë mundësi për investime afatgjata dhe kthim më të lartë për anëtarët e këtij fondi.

Fondi I Investimit SIGAL INVEST

Fondi i Investimit SIGAL INVEST (në vijim “Fondi”), është një sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, i themeluar nga SIGAL UNIQA INVEST - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. (në vijim “Shoqëria Administruese”), shoqëri administruese e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim “AMF”), për të administruar fonde të pensionit privat dhe sipërmarrje të investimeve kolektive. Shoqëria administruese e zhvillon aktivitetin e saj me ndershmëri, transparencë dhe profesionalizëm në interesin më të mirë të investitorëve. Ky Fond është licencuar në datë 28/02/2023 me vendim Bordi të AMF nr. 17 dhe operon në monedhën vendase në Lekë.

Strategjia e Investimit

Objekti i investimit të Fondit është maksimizimi i kthimit nga investimi nëpërmjet administrimit të aseteve, për një rritje të të ardhurave të investitorit në një periudhë afatmesme duke ruajtur principalin dhe nivelet e mjaftueshme të likuiditetit. Fondi është i përshtatshëm për ata investitorë që janë të gatshëm të ndërmarrin një nivel mesatar rreziku duke investuar në tregun e titujve të borxhit.

Për vitin 2024 Fondi k'ua investuar asetet e tij në obligacione të qeverisë shqiptare kryesisht në Obligacione me afat 7,10 dhe 15 vjeçare.

Struktura aktuale e investimit të Fondit të Investimit paraqitet si më poshtë:

Instrumenti	Vlera në Lekë	Përqindja e asetëve
Obligacione të Qeverisë	2,421,242.18	90.37%
Mjete monetare (Llogari rrjedhëse)	258,156.02	9.63%

Performanca

Fondi është licencuar në datë 28/02/2023, ka filluar veprimtarinë e tij në 19/02/2024 për një afat të pacaktuar për këtë arsye aktualisht nuk ka të dhëna mbi performancën e fondit në të shkuarën.

Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Dhjetor 2024

Vlera Neto e Asetëve	2,672,080.16 Lekë
Çmimi i Kuotës	1,068.6945 Lekë
*Fitimi(31/12/2023-31/12/2024)	6.87%

Tregues të Riskut në 31 Dhjetor 2024

FONDI	Kohëzgjatja	Kohëzgjatja e moderuar	Devijimi standart	Treguesi sintetik i rrezikut
Fondi Pensionit SIGAL	4.80	4.67	0.0001%	1
Fondi Pensionit SIGAL PRO	8.71	8.42	0.04%	1
Fondi i Investimit SIGAL INVEST	6.44	6.24	0.30%	3

Treguesi i riskut sintetik në tabelë jep informacion mbi nivelin e rrezikut të fondit (nga niveli 1, rrezik shumë i ulët deri në nivelin 7, rrezik shumë i lartë). Fondet e Pensionit Privat kanë një nivel rreziku 1, që do të thotë rrezik i ulët, profil shumë konservator dhe të qëndrueshëm. Fondi i Investimit Sigal Invest ka një nivel rreziku 3 që do të thotë rrezik mesatar, më dinamik dhe më i përshtatshëm për investitorët që pranojnë më shumë rrezik në këmbim të potencialit më të lartë për kthim.

Administrimi i Riskut kryhet nga një njësi e pavarur e cila mat, monitoron, dhe raporton në Këshillin e Administrimit, Komitetin e Investimit dhe AMF respektimin e limiteve dhe treguesit e ndryshëm të riskut. Ky departament është i ngarkuar me identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve të lidhura me investimet. Kjo përfshin analizën e rreziqeve financiare, operacionale, dhe të tregut, që mund të ndikojnë në kthimin e investimeve.

Për fondet e Pensionit Privat SIGAL dhe SIGAL PRO, treguesit kanë qenë stabil dhe luhatshmëria ka qenë e ulët, të gjitha investimet e fondeve mbahen deri në maturim.

Fondi I Investimit SIGAL INVEST ka pasur një luhatshmëri më të lartë, kjo për shkak të luhatshmërisë së lartë në tregjet e obligacioneve ku ky fond aktualisht investon.

Lidhur me **kohëzgjatjen dhe kohëzgjatjen e moderuar**, Fondi I Pensionit Sigal PRO dhe Fondi I Investimit Sigal Invest janë disi më të ekspozuar ndaj rrezikur nga ndryshimet e normave të interesit, ndërkohë që Fondi SIGAL ka një ndjeshmëri më të ulët dhe është më i qëndrueshëm ndaj këtyre luhatjeve.

Devijimi Standart mat variacionin e kthimeve pra rrezikun total të Fondit. Fondi I Pensionit SIGAL dhe Sigal PRO janë fonde të qëndrueshme dhe thuajse pa luhatje të kthimeve. Fondi I Investimit Sigal Invest është disi më i ndjeshëm dhe potencialisht ka luhatje më shumë në fitim apo humbje.

Pasqyrat Financiare & Raporti i Audituesit të Pavarur

SIGAL UNIQA INVEST
Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe
Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(me Raportin e Audituesit të Pavarur bashkëlidhur)

PËRMBAJTJA

Raporti i audituesit të pavarur.....	1
Pasqyrat financiare	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime shpjeguese	
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Bazat e përgatitjes.....	5
3. Politikat domethënëse kontabël	6
4. Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve	11
5. Ndryshimet në politikat kontabël.....	11
5.1. Miratimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara	11
5.2. Ndryshimet e reja kontabël	11
6. Administrimi i rrezikut financiar.....	12
6.1. Rreziku i tregut	13
6.1.1. Rreziku i monedhës	13
6.1.2. Rreziku i normës së interesit.....	13
6.2. Rreziku i likuiditetit	14
6.3. Rreziku kreditor	15
6.4. Rreziku operacional	16
6.5. Administrimi i kapitalit	16
7. Paraqitje me vlerën e drejtë.....	16
8. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	17
9. Investime në letra me vlerë	18
10. Shpenzime të shitjes së kontratave	18
11. Pasuri me të drejtë përdorimi dhe detyrime të qirasë.....	18
12. Pajisjet	19
13. Aktive të tjera	19
14. Llogari të pagueshme	20
15. Llogari të pagueshme të tjera	20
16. Kapitali aksionar	20
17. Të ardhura nga administrimi i fondit.....	21
18. Të ardhura nga interesi e të tjera.....	21
19. Shpenzime për personelin.....	21
20. Shpenzime administrative	21
21. Tatim mbi të ardhurat	22
22. Angazhime dhe detyrime të konstatuara	22
23. Transaksionet me palët e lidhura	22



Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerëve të Sigal Uniqa Invest Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.:

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Sigal Uniqa Invest Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2024, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet e Kontabilitetit IFRS.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë informacione domethënëse për politikën kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK") dhe kërkesat e Kodit të Etikës për Audituesit Ligjorë që janë të zbatueshme për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbyllur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së dhe kërkesat e Kodit të Etikës për Audituesit Ligjorë.

Përgjegjësitë e drejtuesve dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet e Kontabilitetit IFRS, dhe për kontrollin e brendshme, të cilat ata i gjykojnë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtuesit janë përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vendosur në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtuesit synojnë që Shoqëria të likuidohet apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç këtyre.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.



Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por ajo nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshtëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësive, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose shmangie të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe të shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtuesit.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtuesit dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të përfshijmë një rezervë në opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese si dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që të sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Auditues Ligjor

Jonid Lamitari



PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
30 prill 2025
Tiranë, Shqipëri

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.
(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
AKTIVET			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	8	691	50
Depozita me afat me bankat	8.1	-	15,800
Investime në letra me vlerë	9	49,464	50,844
Parapagime të tatimit mbi të ardhurat		318	-
Shpenzime të shitjes së kontratave	10	89,602	72,658
Pasuri me të drejtë përdorimi	11	4,967	7,450
Pajisje	12	2,171	2,154
Aktive të tjera	13	6,540	7,687
TOTALI I AKTIVEVE		153,753	156,643
Detyrime			
Llogari të pagueshme	14	734	2,478
Detyrimet e qirasë	11	5,432	8,207
Detyrime të tjera	15	3,357	13,808
Detyrime tatimi mbi të ardhurat		-	916
TOTALI I DETYRIMEVE		9,523	25,409
Kapitali			
Kapitali aksioner	16	57,029	57,029
Fitim i mbartur		87,201	74,205
TOTALI I KAPITALIT		144,230	131,234
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		153,753	156,643

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A më datë 28 prill 2025 dhe u firmosën në emër të saj nga:

Elvis Ponar
Administrator



Junida Ramku
Finance Manager

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.
(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të ardhura nga administrimi i fondit	17	60,265	64,061
Të ardhura nga interesi e të tjera	18	3,665	2,186
Totali i të ardhurave		63,930	66,247
Shpenzime për personelin	19	(29,915)	(30,989)
Shpenzime administrative	20	(10,761)	(10,151)
Shpenzim i shitjes së kontratave	10	(4,716)	(3,824)
Shpenzim amortizimi	11,12	(2,778)	(2,762)
Shpenzimet e interesit	11	(522)	(915)
Totali i shpenzimeve		(48,692)	(48,641)
Fitimi para tatimit		15,238	17,606
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	21	(2,242)	(2,754)
Fitimi mbi të ardhurat		12,996	14,852
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		12,996	14,852

Shënimet shoqëuese në faqet 5 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruuese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.
(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

	Kapitali aksioner	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja më 1 Janar 2023	57,029	59,353	116,382
Fitimi i vitit	-	14,852	14,852
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<i>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	14,852	14,852
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	57,029	74,205	131,234
Gjendja më 1 Janar 2024	57,029	74,205	131,234
Fitimi i vitit	-	12,996	12,996
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<i>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	12,996	12,996
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	57,029	87,201	144,230

Shënimet shoqëuese në faqet 5 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondëve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.
(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Pasqyra e flukseve monetare

	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit		12,996	14,852
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimin		2,778	2,762
Shpenzime për tatimin mbi të ardhurat		2,242	2,754
Shpenzime interesi	16	522	915
Të ardhura nga interesi		(3,665)	(2,186)
Flukset e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative		14,873	19,097
Ndryshimet në kapitalin punues			
Ndryshime në aktive të tjera		1,147	(2,415)
Ndryshime në llogari të pagueshme		2,725	774
Ndryshime në detyrime të tjera		(10,451)	4,688
Ndryshime në shpenzime të shitjes së kontratave		(16,944)	(17,031)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative		(23,523)	(13,984)
Tatim fitimi i paguar		(3,477)	(791)
Interesi i paguar		(522)	-
Interesi i arkëtuar		3,045	1,861
Flukset monetare neto të (përdorura) gjeneruar nga aktivitetet operative		(9,604)	6,183
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerja e pajisjeve		(312)	(1,718)
Depozita bankare		15,800	(15,800)
Shitje investimesh me kosto të amortizuar		30,000	60,000
Blerje e investimeve me kosto të amortizuar		(28,000)	(50,000)
Flukse monetare neto të gjeneruara (përdorura) në aktivitetet investuese		17,488	(7,518)
Flukse monetare nga aktivitetet investuese			
Pagesat e qirasë		(7,243)	-
Flukse monetare neto të përdorura në aktivitetet financuese		(7,243)	-
Rritje/(rënie) neto në flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre		641	(1,335)
Flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës		50	1,385
Flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	8	691	50

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

SIGAL UNIQA INVEST Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A. ("Shoqëria"), është një shoqëri aksionare shqiptare e themeluar në Shqipëri. Shoqëria është regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 34877, datë 21. Janar 2006.

Aktiviteti Kryesor

Më 30 Mars 2011, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ("AMF") licensoi Shoqërinë për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar, në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit.

Adresa e regjistruar

Selia qendrore e Shoqërisë ndodhet në rrugën "Ukraina e Lirë", pallati Teknoprojekt, kati përdhe, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria zotërohet me 51% nga Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A. dhe 49% nga z. Avni Ponari. Pala përfundimtare dhe kontrolluese e Shoqërisë është UNIQA Versicherungsverein Privatstiftung.

Veprimtaria drejtohet nga Këshilli i Administrimit që përbëhet nga pesë anëtarë:

- Z. Adrian Totokoçi,
- Z. Klement Mersini,
- Z. Abdyl Sarja,
- Z. Edvin Hoxhaj, dhe
- Z. Elvis Ponari

Këshilli ka emëruar Z. Elvis Ponari si Administrator të Shoqërisë.

Shoqëria Administruese menaxhon Fondin Vullnetar të Pensionit "Sigal", Fondin e Pensionit Privat "Sigal Pro" dhe sipërmarrjen e investimeve kolektive "Sigal Invest". Për të gjitha këto fonde, aktivet janë në pronësi të përfituesve përkatës. Depozitarit të secilit fond i kërkohet që të ruajë mjetet, veprimtarinë dhe të dhënat e fondeve veçmas nga mjetet, operacionet dhe regjistrat e veta apo të shoqërisë së administrimit. Prandaj, të dhënat e kontabilitetit të fondeve dhe shoqërisë administruese mbahen veçmas, si dhe pasqyrat financiare përkatëse përgatiten po veçmas.

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare paraqiten në lekë, të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt. Leku shqiptar është gjithashtu monedha funksionale e Shoqërisë, monedha e mjedisit ekonomik kryesor ku ajo ushtron veprimtarinë.

2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") – Standardet e Kontabilitetit IFRS, bazuar në parimin e kostos historike.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

3. Politikat domethënëse kontabël

a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta të huaja përkthehen në monedhën funksionale duke përdorur kurset e këmbimit të datave të transaksioneve. Aktivët dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit të datës së raportimit. Fitimet ose humbja në valutë të huaj nga zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të përkthyer me kursin e këmbimit në fund të vitit. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedhë të huaj që maten me vlerën e drejtë kthehen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten bazuar në koston historike në valutë të huaj, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në valutë të huaj që lindin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje.

b) Të ardhura nga administrimi i fondeve

Të ardhurat maten në bazë të tarifës së specifikuar në kontratën me fondin që përfaqësohet nga prospekti. Shoqëria njihet të ardhurat kur transferon kontrollin tek mbajtësit e aktiveve të fondeve. Tarifa e administrimit llogaritet në baza ditore si përqindje vjetore ndaj vlerës neto të aktiveve (NAV) të secilit fond (ditore, d.m.th. $x\%/365$) plus një tarifë mujore shtesë prej $x\%$ mbi tarifën e administrimit (në baza ditore ose $x\%/365$). Tarifa e përfundimit të parakohshëm, e paguar nga anëtarët e fondeve për tërheqje të parakohshme nga fondet e pensionit llogaritet si përqindje e vlerës neto të fondeve të anëtarit (pa tatimin e mbajtur në burim) në ditën e tërheqjes. Kjo përqindje ndryshon nga 2 në 15 % në varësi të kohës që anëtari ka investuar në fond. Të ardhurat njihen me kalimin e kohës kur ofrohet shërbimi. Faza e përfundimit për përcaktimin e shumës së të ardhurave që do të njihet vlerësohet në baza ditore. Të ardhurat nga administrimi i fondeve përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme për shërbimet e administrimit në rrjedhën e zakonshme të veprimtarisë së Shoqërisë. Kostot për të marrë një kontratë (komisionet) njihen si kosto shtesë për të marrë një kontratë të re dhe kapitalizohen si aktiv i kontratës. Ato shpërndahen në fitim ose humbje në një bazë sistematike lineare përgjatë periudhës mesatare të kontratave të fondeve të vlerësuar nga Shoqëria në datën e raportimit rreth 20 vjet (nga lidhja e kontratës deri në mbushjen e moshës së pensionit). Afati mesatar rrvlerësohet në çdo datë raportimi. Një aktiv i kontratës që rrjedh nga kostot për të marrë një kontratë nuk mund të ndahet në baza individuale.

c) Interesi

Norma efektive e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon saktësisht pagesat e vlerësuar monetare të ardhshme dhe arkëtimet gjatë jetës së pritshme të aktivit ose detyrimit financiar deri në:

- vlerën kontabël bruto të aktivit financiar; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Kosto e amortizuar dhe vlera kontabël bruto

Kostoja e amortizuar e një aktivit ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivit ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet shumës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim dhe, për aktivet financiare, rregulluar për çdo zhvlerësim nga humbjet e pritshme kreditore. Vlera kontabël bruto e një aktivit financiar është kostoja e amortizuar e aktivit financiar përpara zbritjes së provizionit për humbjet e pritshme kreditore.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

3 Politika domethënëse kontabël (vazhdim)

d) Instrumentet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Shoqëria njeh llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat fillimisht në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (përfshirë blerjet dhe shitjet e detyruara të aktiveve financiare) njihen fillimisht në datën në të cilën Shoqëria bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit. Një aktiv financiar ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit.

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëposhtme.

Aktivitet financiar

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me kosto të amortizuar. Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përveç rastit kur Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivet financiare të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit. Aktivi financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është i përcaktuar me vlerë të drejtë në fitim/humbje:

- aktivi mbahet sipas një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale; dhe,
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar gjenerojnë në datat e caktuara flukse monetare, të cilat përbëjnë vetëm pagesa të kryejshme dhe interesit ndaj kryejshme të papaguar.

(iii) Vlerësimi i modelit të biznesit

Shoqëria vlerëson objektivat e modeleve të biznesit sipas të cilave menaxhohet një aktiv në nivel portofoli sepse kjo reflekton mënyrën më të mirë sesi menaxhohet biznesi dhe si informacioni i paraqitet drejtimit. Informacioni i vlerësuar përfshin politikat dhe objektivat e përcaktuara të portofolit dhe zbatimi i tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejtimit fokusohet në fitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të caktuar të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato aktive ose realizojnë flukse monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve; dhe shpeshtësinë, vëllimin dhe kohën e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet e shitjeve të tilla dhe pritshmëritë e tij për aktivitetin e shitjeve në të ardhmen. Megjithatë, informacioni mbi shitjet nuk merret parasysh i izoluar, por si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm se si arrihen nga Shoqëria objektivat e përcaktuara për menaxhimin e aktiveve financiare dhe si realizohen flukset e mjeteve monetare të ardhshme. Drejtimi i Shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës ka investuar në letra me vlerë të emetuara nga bankat e nivelit të dytë dhe Qeveria Shqiptare për t'i mbajtur ato deri në maturim dhe për të mbledhur interesin dhe principalin (modeli i biznesit Hold-to-Collect). Një shitje që ndodhi gjatë vitit nuk konsiderohet si mos-përputhje me modelin e biznesit pasi ishte një shitje e detyruar për të siguruar përputhshmërinë e llojeve të investimit me rregulloret në fuqi.

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit ("VPPI")

Për qëllim të këtij vlerësimi, "principal" është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. "Interesi" është shpërblimi për vlerën në kohë të parës dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të paslyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit. Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Shoqëria merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

3 Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)

Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin. Letrat me vlerë të investimit të Shoqërisë përmbushin testin SPPI pasi Shoqëria mbledh vetëm principalin dhe interesin dhe nuk është identifikuar asnjë veçori që do të dështonte në test.

Aktivitet dhe detyrimet financiare - Matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet

Aktivitet financiar dhe detyrimet të njohura me koston e amortizuar mjedhimisht maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga interesi, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose humbje.

(vi) *Matja e vlerës së drejtë*

"Vlera e drejtë" është çmimi që do të arketohet nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Shoqëria ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rezikun e tij të mosekzekutimit. Duke qenë se nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv për investimet e Shoqërisë, Shoqëria përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve të pavëzhgueshme për dhënien e informacioneve shpjeguese të vlerës së drejtë. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të mermin parasysh në përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

(vii) *Zhvlersimi*

Shoqëria njeh një zbritje për HPK për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar dhe e mat zbritjen

Shoqëria e konsideron një aktiv financiar në rezik mosshlyerje kur:

- kundërparta ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Shoqërisë pa masa shtrënguese nga ana e Shoqërisë siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;
- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

HPK-të 12-mujore janë ato pjesë të HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit, që janë të mundshme të ndodhin brenda 12 muajve nga data e raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet HPK 12-mujore referohen si "Instrumente financiare në Fazën 1". HPK përgjatë gjithë jetës së aktivitetit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar.

HPK maten si mesatare e ponderuar sipas probabilitetit të ndodhjes së humbjeve të kredisë. Humbjet kreditore janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (diferenca mes flukseve të mjeteve monetare që duhet t'i paguhen Shoqërisë në përputhje me kontratën dhe flukseve të mjeteve monetare që Shoqëria pret të marrë) HPK skontohej duke përdorur normën efektive të aktivitetit financiar.

e) Mjetet financiare me kosto të amortizuar

Mjetet financiare përfshijnë letrat me vlerë të borxhit të matura me kosto të amortizuar.

f) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare mjaft likuide me maturitet tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat janë subjekt i një reziku jo të rëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Shoqëria për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

g) Pajisjet

Njohja dhe matja

Pajisjet, pjesë e Aktiveve afatgjata materiale, maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

3 Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)

Kosto vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera përmblledhëse në momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë të linjës së drejtë gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të secilës pjesë të një zëri të aktiveve dhe pajisjeve. Aktivet e huazuara me qira financiare zhvlerësohen gjatë afatit më të shkurtër të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhat aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Instalime kompjuterike	4 vjet
Mjete transporti	10 vjet
Pajisje zyre	10 vjet

Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlerat e mbetura rивlerësohen në datën e raportimit.

h) Të drejtat e përdorimit të aktiveve

Shoqëria si qiramarrëse

Shoqëria merr me qira ambientet e saj të selisë qendrore. Kontratat mund të përmbajnë komponentë të qirasë dhe jo-qirasë. Për qiratë e pasurive të paluajtshme (pasuritë) për të cilat Shoqëria është qiramarrëse, ajo ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit e qirasë dhe jo-qirasë dhe në vend të kësaj i llogaritë këto si një përbërës të vetëm qiraje.

Aktivët që dalin nga një qira fillimisht maten mbi bazën e vlerës aktuale (detyrimi i qirasë). Aktivët me të drejtën e përdorimit maten me koston që përfshin shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë. Aktivët me të drejtën e përdorimit në përgjithësi amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër të jetës së dobishme të aktivit dhe afatit të qirasë në bazë lineare. Nëse Shoqëria është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të ushtrojë një opsion blerjeje, aktivi i së drejtës së përdorimit amortizohet gjatë jetës së dobishme të aktiveve bazë. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtën e përdorimit llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme të parashikuar të ndërtesave prej 5 vitesh.

Njohja dhe detyrimet e qirasë

Detyrimet që rrjedhin nga një qira maten fillimisht mbi bazën e vlerës aktuale. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën aktuale neto të pagesave fikse (duke përfshirë pagesat fikse në thelb).

Opsionet e zgjatjes (ose opsionet e periudhës pas përfundimit) përfshihen në afatin e qirasë vetëm nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të zgjatet (ose nuk do të përfundojë). Pagesat e qirasë që do të kryhen sipas disa opsioneve të arsyeshme të zgjatjes përfshihen gjithashtu në matjen e detyrimit. Pagesat e qirasë skontoohen duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira. Meqenëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, gjë që ndodh në përgjithësi për qiratë e Shoqërisë, përdoret norma rritëse e huamarrjes së Shoqërisë, duke qenë norma që Shoqëria duhet të paguajë për të marrë huazimin e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme me aktivi me të drejtën e përdorimit në një mjedis të ngjashëm ekonomik me kushte, kolateral dhe kushte të ngjashme.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

3 Politikat domethënëse kontabël (vazhdim)

Për të përcaktuar normën rritëse të huamarrjes, Shoqëria i referohet normës që është në dispozicion të Uniqa Group, e cila:

- përdor një qasje të ndërtuar që fillon me një normë interesi pa rrezik të rregulluar për rrezikun e kredisë, dhe
- bën rregullime specifike të qirasë, p.sh., afati, vendi, monedha dhe kolaterali.

Pagesat e lidhura me qiratë afatshkurtra të pajisjeve dhe automjeteve dhe të gjitha qiratë e aktiveve me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si shpenzim në fitim ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qiratë me një afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak.

i) Përfitimet e punonjësve

(i) Plan me kontribute të përcaktuara

Detyrimet për kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen në fitim ose humbje pasi ofrohet shërbimi përkatës dhe përfshihet në shpenzimet e personelit.

(ii) Kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore

Shoqëria paguan kontribute të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në një fond që operohet nga shteti shqiptar, që ofron përfitime pensioni, shëndetësore dhe përfitime të tjera sociale për punonjësit. Detyrimet për të tilla kontribute njihen në fitim ose humbje kur ato janë të detyrueshme dhe përfshihen në shpenzimet e personelit. Shteti shqiptar është përgjegjës për përcaktimin e kufirit minimal ligjor për të tilla kontribute. E njëjta gjë vlen edhe për kontributet e shoqërisë në pensionet private për llogari të punonjësve.

(iii) Lejet vjetore të paguara

Shoqëria njeh si një detyrim shumë të pazbritur të kostos së përllogaritur në lidhje me lejet vjetore të cilat priten të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e plotësuar.

j) Shpenzim për tatimin mbi të ardhurat

Shpenzimi për tatim mbi të ardhurat përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesat dhe gjobat në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, trajtohen sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivët e kushtëzuara. Tatimi mbi të ardhurat llogaritet duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që kanë hyrë në fuqi kryesisht në datën e raportimit. Pasuritë dhe detyrimet tatimore rrjedhëse mund të kompensohen vetëm nëse plotësohen disa kriterë. Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë njihet për humbjet e papërdorura tatimore dhe diferencat e përkohshme të zbritshëm për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen bazuar në anulimin e diferencave përkatëse të përkohshme të tatimit. Nëse shumat e diferencave të përkohshme është e pamjaftueshme për të njohur një aktiv tatim të shtyrë të plotë, atëherë fitime të ardhshme të tatueshme, të rregulluar me anulimet e diferencave ekzistuese të përkohshme, konsiderohen, bazuar në planin e biznesit. Aktivët tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor i lidhur me to të realizohet; të tilla reduktime anulohen kur probabiliteti i fitimeve të ardhshme të tatueshme përmirësohet. Aktivët tatimore të shtyra të panjohura rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme mund të ekzistojnë ndaj të cilave mund të përdoret. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore të cilat priten të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato anulohen, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruuese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, drejtimi ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrime, të ardhura dhe shpenzime. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive. Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare lidhet me:

Kostot e marrjes së kontratës

Shoqëria përdor një periudhë 20 vjeçare ose normë 5% për të njohur kostot e marrjes së kontratave (komisionet) në fitim ose humbje. Një përcaktim i tillë bazohet në periudhën mesatare për të arritur moshën e pensionit të anëtarëve aktualë. Identifikimi specifik dhe shpërndarja e kostove të tilla në baza individuale nuk është e realizueshme. Nëse periudha mesatare ose norma rritet/ulet me 20%, fitimi për vitin do të zvogëlohej/rritej me 1,011 mijë lekë (2023: 896 mijë lekë).

5. Ndryshimet në politikat kontabël

5.1. Miratimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara

Ndryshimet e mëposhtme hynë në fuqi nga 1 janari 2024:

- Ndryshimet në IFRS 16 Qiratë: Përgjegjësia e qirasë në një shitje dhe qiradhënie (publikuar më 22 shtator 2022 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2024).
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale – Ndryshimet në IAS 1 (të publikuara fillimisht më 23 janar 2020 dhe më pas të ndryshuara më 15 korrik 2020 dhe 31 tetor 2022, përfundimisht efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2024).
- Ndryshimet në IAS 7 Pasqyra e flukseve monetare dhe IFRS 7 Instrumentet financiare: Shpalosjet e marrëveshjeve të financimit me furnitorët (publikuar më 25 maj 2023).

Zbatimi i ndryshimeve nuk kishte ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

5.2. Ndryshimet e reja kontabël

Disa standarde dhe interpretime të reja të publikuara që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2025 ose më vonë, dhe të cilat Shoqëria nuk i ka miratuar më herët:

- Ndryshimet në IAS 21 Mungesa e shkëmbimit (publikuar më 15 gusht 2023 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2025).
- Ndryshimet në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare - Ndryshimet në IFRS 9 dhe IFRS 7 (publikuar më 30 maj 2024 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2026).
- IFRS 18 Paraqitja dhe shpalosja në pasqyrat financiare (publikuar më 9 prill 2024 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2027).
- IFRS 19 Filiale pa përgjegjëshmëri publike: Shpalosje (publikuar më 9 maj 2024 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2027).

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

5. Ndryshimet në politikat kontabël (vazhdim)

5.1 Ndryshimet e reja kontabël (vazhdim)

- IFRS 14, Llogaritë rregullatore të shtyrjes (publikuar më 30 janar 2014 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2016).
- Shitja ose kontributi i asetëve midis një Investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose ndërmarrjes së përbashkët – Ndryshimet për IFRS 10 dhe IAS 28 (lëshuar më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas një date që do të përcaktohet nga IASB).
- Përmirësimet vjetore në Standardet e Kontabilitetit IFRS (publikuar në korrik 2024 dhe me efekt nga 1 janari 2026).

Përveç nëse përkthehet ndryshe më lart, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

6. Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria ka ekspozim ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare :

- rreziku kreditor;
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim shpjegues përmban informacion në lidhje me ekspozimin e Shoqërisë ndaj rreziqeve të renditura më sipër, dhe politikat dhe procedurat për menaxhimin e këtyre rreziqeve dhe menaxhimit të kapitalit të Shoqërisë.

Kuadri i administrimit të rrezikut

Roli i administrimit të rrezikut në strukturën e Shoqërisë nënkupton përgjegjësinë në lidhje me administrimin e rreziqeve që raportojnë drejtpërdrejt në Këshillin e Administrimit. Administrimi i rrezikut financiar në Shoqëri fillon nga identifikimi i rreziqeve, vendosja e burimeve të përshtatshme për administrimin e rrezikut, përcaktimi i kufijve mbi ekspozimet, kufizimet e monitorimit dhe rregullimi i ekspozimeve ndaj intervaleve të kërkuara. Kompetencat e Këshillit të Administrimit përfshijnë kontrollin dhe mbikëqyrjen kundrejt zbatimit të politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administrative; miratimin e politikave financiare dhe investuese; caktimin dhe shkarkimin e administratorëve ose anëtarëve të Komitetit të Investimit.

Këshilli i Administrimit caktoi anëtarët e Komitetit të Investimeve si më poshtë:

- Z. Elvis Ponari, Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese
- Z. Klement Mersini, Drejtor i Departamentit të Financës në Shoqërinë e Sigurimeve "SIGAL Uniqa Group Austria
- Z. Blodin Çuçi, Administrator i Caesar Investment Advisory Services
- Z. Naim Hasa, Këshilltar

Komiteti i Investimit organizon jo më pak se katër mbledhje në vit, në mënyrë që të zhvillojë politika investimi, të kryejë shpërndarjen dhe modifikimin e aktiveve dhe t'ia paraqesë ato Shoqërisë Administruese. Këto politika mbështeten mbi analiza sasiore dhe cilësore të tregjeve të kapitalit, tregjeve të rrezikut dhe analiza të tjera teknike në përputhje me kufizimet dhe kufijtë maksimalë të investimit të përcaktuar nga ligji dhe rregulloret e përmendura më lart.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

6.1. Rreziku i tregut

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të tregut. Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në (a) monedhat e huaja, (b) aktivet dhe pasivet që sjellin interesa dhe (c) instrumentet e kapitalit neto, të cilat janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Drejtimi përcakton kufijtë mbi vlerën e rrezikut që mund të pranojë, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut. Ndjeshmëria ndaj rreziqeve të tregut paraqitet më poshtë dhe ato bazohen në një ndryshim në një faktor, duke mbajtur të gjithë faktorët e tjerë konstant. Në praktikë kjo nuk ka gjasa të ndodhë dhe ndryshimet në disa nga faktorët mund të lidhen - për shembull, ndryshimet në normën e interesit dhe ndryshimet në normat e monedhës së huaj.

6.1.1. Rreziku i monedhës

Shoqëria mund të kryejë transaksione në valutë vendase dhe të huaja; si rrjedhim lindin ekspozime ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Rreziku i valutës së huaj lind kur vlera e transaksioneve të ardhshme dhe aktiveve dhe detyrimeve monetare të njohura të shprehura në monedha të tjera luhatet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit të huaj. Rreziku i monedhës në portofolin e investimit menaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së aktiveve/detyrimeve. Ekspozimet në valutë përmbajnë rrezikun e lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit. Megjithatë, Shoqëria nuk ka aktive dhe detyrime financiare në valutë të huaj më 31 dhjetor 2024 dhe 2023.

6.1.2. Rreziku i normës së interesit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të instrumenteve të saj financiare do të luhaten si rezultat i ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Rreziku i normës së interesit përbëhet nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në pozicionin e tij financiar dhe flukset monetare. Prandaj, kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është fiksuar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Një përmbledhje e hendekut të normës së interesit të Shoqërisë, e analizuar në datën e rivlerësimit kontraktual ose datën e maturimit, është si më poshtë:

31 Dhjetor 2024	Vlera kontabël	Më pak se 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri më 1 vit	Më shumë se 1 vit
Aktivët Financiare					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	691	691	-	-	-
Investime në letra me vlerë	49,464	-	-	-	49,464
Aktive të tjera financiare	6,540	6,540	-	-	-
Totali i aktiveve financiare	56,695	7,231	-	-	49,464
Detyrimet financiare					
Llogari të pagueshme	734	734	-	-	-
Detyrime për qiranë	5,432	-	-	-	5,432
Detyrime të tjera	3,357	3,357	-	-	-
Totali i detyrimeve financiare	9,523	4,091	-	-	5,432
Hendeku i normës së interesit	47,172	3,140	-	-	44,032

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

31 Dhjetor 2023	Vlera kontabël	Më pak se 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3muaj deri më 1 vit	Më shumë se 1 vit
Aktivët Financiare					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	50	50	-	-	-
Depozitat me afat me bankat	15,800	-	-	15,800	-
Investime në letra me vlerë	50,844	-	-	-	50,844
Aktive të tjera financiare	7,687	-	7,687	-	-
Totali i aktiveve financiare	74,381	50	7,687	15,800	50,844
Detyrimet financiare					
Llogari të pagueshme	2,478	-	-	2,478	-
Detyrime për qiranë	8,207	-	-	-	8,207
Detyrime të tjera	14,724	-	-	14,724	-
Totali i detyrimeve financiare	25,409	-	-	17,202	8,207
Hendeku i normës së interesit	48,972	50	7,687	(1,402)	42,637

6.2. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet e saj financiare që shlyhen duke dhënë hua ose ndonjë aktiv financiar tjetër. Politika e Shoqërisë është të investojë në letra me vlerë që do të mbahen deri në maturim. Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

31 Dhjetor 2024	Vlera kontabël	Më pak se 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri më 1 vit	1 deri në 5 vjet
Aktivët Financiare					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	691	691	-	-	-
Investime në letra me vlerë	49,464	-	-	1,464	48,000
Aktive të tjera financiare	6,540	6,540	-	-	-
Totali i aktiveve financiare	56,695	7,231	-	1,464	48,000
Detyrimet financiare					
Llogari të pagueshme	734	734	-	-	-
Detyrime për qiranë	5,432	238	476	2,142	2,576
Detyrime të tjera	3,357	3,357	-	-	-
Totali i detyrimeve financiare	9,523	4,329	476	2,142	2,576
Hendeku neto i likuiditetit	47,172	2,902	(476)	(678)	45,424

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

31 Dhjetor 2023	Vlera kontabël	Më pak se 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3muaj deri më 1 vit	1 deri në 5 vjet
Aktivët Financiare					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	50	50	-	-	-
Depozita me afat me bankat	15,800	-	-	15,800	-
Investime në letra me vlerë	50,844	-	-	844	50,000
Aktive të tjera financiare	7,687	-	7,687	-	-
Totali i aktiveve financiare	74,381	50	7,687	16,644	50,000
Detyrimet financiare					
Llogari të pagueshme	2,478	-	-	2,478	-
Detyrime për qiranë	8,207	251	502	2,259	5,195
Detyrime të tjera	14,724	-	-	14,724	-
Totali i detyrimeve financiare	25,409	251	502	19,461	5,195
Hendeku neto i likuiditetit	48,972	(201)	7,185	(2,817)	44,805

6.3. Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale. Për qëllime të raportimit për administrimin e rrezikut, Shoqëria konsideron këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor (të tilla si rreziku individual dhe rreziku i sektorit). Këshilli i Administrimit së Shoqërisë ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut kreditor tek Drejtimi, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut kreditor të Shoqërisë. Investimet e Shoqërisë janë obligacionet e Qeverisë Shqiptare dhe të Bankës Credins. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal kreditor. Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut kreditor në datën e raportimit është si më poshtë.

Kategoria	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Paraja dhe ekuivalentët e saj	8	691	50
Depozitat me afat me bankat	8.1	-	15,800
Investime në letra me vlerë	9	49,464	50,844
Aktive të tjera financiare	13	6,540	7,687
Vlera kontabël		56,695	74,381

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Llogaritë mjedhëse të Shoqërisë mbahen kryesisht pranë Bankës Amerikane të Investimeve, e cila është një bankë tregtare që ushtron veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe është gjithashtu kujdestare e fondit të pensioneve vullnetare "Sigal" të administruar nga Shoqëria. Banka nuk vlerësohet nga një organizatë e pavarur vlerësimi. Shoqëria ka gjithashtu llogari mjedhëse me Union Bank, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Credins. Bankat e nivelit të dytë që ushtrjnë veprimtarinë në Shqipëri rregullohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë e cila monitoron pozicionin e tyre të likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme. Nga Banka Qendrore nuk është komunikuar asnjë çështje lidhur me pozicionin e likuiditetit të bankave të mbikëqyrura prej saj. Rrjedhimisht, Shoqëria nuk ka llogaritur një HPK për këtë ekspozim pasi konsiderohet si jo-domethënës.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive S.H.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Investimet e letrave me vlerë

Rreziku kreditor i portofolit të letrave me vlerë të Shoqërisë vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së Qeverisë Shqiptare (për obligacionet 15-vjeçare të emetuara nga Qeveria Shqiptare me vlerë nominale 28,000 mijë lekë) dhe aftësisë së Banka Credins për obligacionin e saj 7 vjeçar me vlerë nominale 20,000 mijë lekë për të përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale për kuponat dhe shlyerjen e vlerës nominale.

Qeveria shqiptare është vlerësuar si BB (përmirësuar nga BB-), dhe e qëndrueshme, nga Standard & Poor's dhe Ba3, të qëndrueshëm, bazuar në vlerësimin kreditor të Moody's. Nuk ka asnjë tregues për një rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Banka Credins është nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë e cila raporton çdo gjashtë muaj për gjendjen e likuiditetit të sistemit bankar në Shqipëri. Nuk ka të dhëna nga Banka e Shqipërisë për probleme likuiditeti për asnjë nga bankat nën mbikëqyrjen e saj. Kuponët janë shlyer nga Banka Credins në mënyrë të rregullt.

6.4. Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë si pasojë e një shumëllojshmërie shkakqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Shoqërisë, si dhe nga faktorë të jashtëm përveç reziqeve kreditore, tregut dhe likuiditetit të tilla si ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore, standardet përgjithësisht të pranueshme të sjelljes së korporatave përjashtuar reputacionin dhe rrezikun strategjik. Qëllimi i Shoqërisë është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmagjen e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësi primare për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i caktohet Këshillit të Administrimit.

6.5. Administrimi i kapitalit

Sipas ligjit 76/2023, neni 10, pika 1, shoqëria administruese duhet të mbajë kapital të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në kohën e duhur dhe në çdo rrethanë ai duhet të jetë jo më pak se 15 800 mijë lekë në çdo kohë. Shoqëria e ka përmbushur këtë kriter në datën e raportimit pasi kapitali i saj neto është 144,230 mijë lekë.

7. Paraqitje me vlerën e drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Shoqëria duhet të klasifikojë, për qëllim paraqitjeje, matjet me vlerë të drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë që të reflektojë rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes. Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e kuotuar në treg për instrumente me afat të ngjashëm me afatin e mbetur të instrumenteve në të cilat ajo ka investuar. Përgjithësisht Shoqëria përdor informacionin e publikuar nga Banka e Shqipërisë për instrumentat e tregtuara prej saj duke përdorur kështu teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të aktualizimit të flukseve të ardhshme të shoqërisë me normat e interesit të ofruara nga instrumente të ngjashme nga pikëpamja e afatit të mbetur për të cilët ekzistojnë çmime të matshme tregu. Shoqëria mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë që pasqyron rëndësinë e inputeve të përdorura në bërjen e matjeve: Niveli 1: Çmimi i tregut i kuotuar (i pa rregulluar) në një treg aktiv për një instrument identik. Niveli 2: Teknikat e vlerësimit të bazuara në të dhëna të vrojtueshme, në mënyrë direkte (p.sh. çmimet) ose indirekte (p.sh. të derivuara nga çmimet).

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

7. Paraqitje me vlerën e drejtë (vazhdim)

Niveli 2 përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur çmime tregu të kuotura në tregje relativisht aktive për instrumente të ngjashme; çmime të kuotuar për instrumente identike ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut. Për instrumente financiare që tregtohen rrallë dhe nuk ka transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon grada të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, pasigurisë e faktorëve të tregut, supozimet e çmimeve dhe rreziqe të tjera që influencojnë instrumentin specifik.

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë gjendjen në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka rezidente. Duke qenë se këto balanca janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë barazohet me vlerën që mbartin në datën e raportimit.

Investime në letra me vlerë

Letrat me vlerë të investimeve përfshijnë obligacione qeveritare dhe të bankave tregtare. Vlera e drejtë për këto letra me vlerë investimi është vlerësuar duke përdorur një model të skontuar të fluksit monetar të bazuar në një kurbë aktuale të yield-eve të përshtatshme për afatin e mbetur deri në maturim për bonot e thesarit dhe obligacionet e qeverisë shqiptare bazuar në ankandin e tyre të fundit nga data e raportimit (3.95% për obligacionet 5-vjeçare që përkojnë me maturitetin e mbetur të obligacioneve të Bankës Credins dhe 6.41% për obligacionet 15-vjeçar që përkojnë me maturitetin e mbetur të obligacioneve qeveritare). Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e drejta të instrumenteve financiare të pa matura me vlerën e drejtë dhe të analizuar sipas nivellit të hierarkisë së vlerës së drejtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	Niveli i vlerës së drejtë	Kosto e amortizuar	Vlera kontabël neto	Vlera e drejtë
31 Dhjetor 2024				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	Niveli 1	691	691	691
Investime në letra me vlerë	Niveli 2	49,464	49,464	50,253
31 Dhjetor 2023				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	Niveli 1	50	50	50
Depozita me afat me bankat	Niveli 1	15,800	15,800	15,800
Investime në letra me vlerë	Niveli 2	50,844	50,844	55,323

8. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Mjete monetare në bankë	691	50
Total	691	50

Më 31 dhjetor 2024, llogaritë rrjedhëse të Shoqërisë mbahen kryesisht në Bankën Amerikane të Investimeve si dhe në disa banka të tjera tregtare në Shqipëri. Banka e Shqipërisë nuk parashikon çështje likuiditeti që mund të kërkojnë zhvlerësim të parave të Shoqërisë dhe gjendjes së ekuivalentit të saj.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruuese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

8.1 Depozita me afat me bankat

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Union Bank	-	15,800
Total	-	15,800

Depozita me afat kishte një maturim fillestar një vit dhe me normë interesi 3.40%. Depozita nuk u rinovua.

9. Investime në letra me vlerë

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Investime në Obligacione të Qeverisë Shqiptare	28,000	50,000
Obligacion Banka Credins	20,000	-
Interesi i përllogaritur	1,464	844
Total	49,464	50,844

Letrat me vlerë të investimit përfshijnë obligacione të emetuara nga Banka Credins në vlerën 20,000 mijë lekë me normë kupon 7.5% me maturim në vitin 2030 dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare 15-vjeçare në vlerat 16,000 mijë lekë dhe 12,000 mijë lekë me norma kuponi 7.94% dhe 6.8% përkatësisht që matorojnë në vitin 2039.

10. Shpenzime të shitjes së kontratave

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Më 1 Janar	72,658	55,627
Shpenzimi i shitjes së kontratave	21,680	20,855
Amortizimi i shpenzimeve të shitjes së kontratave për vitin	(4,716)	(3,824)
Më 31 Dhjetor	89,602	72,658

11. Pasuri me të drejtë përdorimi dhe detyrime të qirasë

	Ndërtesa
Kosto	
Më 1 Janar 2023	-
Shtesa	9,933
Më 31 Dhjetor 2023	9,933
Shtesa	-
Më 31 Dhjetor 2024	9,933
Amortizimi	
Më 1 Janar 2023	-
Shpenzimi i vitit	2,483
Më 31 Dhjetor 2023	2,483
Shpenzimi i vitit	2,483
Më 31 Dhjetor 2024	4,966
Vlera e mbartur	
Më 31 Dhjetor 2023	7,450
Më 31 Dhjetor 2024	4,967

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

11. Pasuri me të drejtë përdorimi dhe detyrime të qirasë (vazhdim)

Shoqëria njohu detyrimet e qirasë si më poshtë:	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Detyrimet e qirasë afatshkurtër	2,853	2,853
Detyrimet e qirasë afatgjatë	2,579	5,354
Totali i detyrimeve të qirasë	5,432	8,207

Shoqëria ka një kontratë qiraje për ndërtesën e saj qendrore, për të cilën ka njohur aktiv me të drejtën e përdorimit për një periudhë 5-vjeçare duke filluar nga 1 janari 2023. Opsionet e rinovimit janë në dispozicion të Shoqërisë. Megjithatë, drejtimi i Shoqërisë nuk ka ende një plan për përdorimin e ndërtesës përtej afatit të specifikuar të qirasë. Shpenzimet e interesit të përfshira në kostot financiare të vitit 2024 ishin 522 mijë lekë (2023: 915 mijë lekë). Dalja totale e parave për qiratë në vitin 2024 ishte 7,243 mijë lekë (2023: nuk kishte pagesa).

12. Pajisjet

	Pajisje zyre	Instalime kompjuterike	Mjete transporti	Totali
Kostot				
Më 1 Janar 2023	617	726	934	2,277
Shlesa	-	816	900	1,718
Më 31 Dhjetor 2023	617	1,544	1,834	3,995
Shlesa	312	-	-	312
Më 31 Dhjetor 2024	929	1,544	1,834	4,307
Amortizimi i akumuluar				
Më 1 Janar 2023	293	335	934	1,562
Shpenzimi i vitit	29	186	64	279
Më 31 Dhjetor 2023	322	521	998	1,841
Shpenzimi i vitit	26	186	83	295
Më 31 Dhjetor 2024	348	707	1,081	2,136
Vlera e mbartur				
Më 31 Dhjetor 2023	295	1,023	836	2,154
Më 31 Dhjetor 2024	581	837	753	2,171

Shoqëria nuk ka aktive afatgjata materiale të vendosura si kolateral më 31 dhjetor 2024 dhe 2023.

13. Aktive të tjera

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të arkëtueshme nga tarifat e administrimit	4,016	5,179
Kontribute paradhënie për Shoqatën e Siguruesve të Jetës, Fondeve të Pensionit dhe Fondeve të Investimeve	2,523	2,501
Të arkëtueshme të tjera	1	7
Totali	6,540	7,687

Pjesa më e madhe e paradhënieve i janë bërë Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Fondeve të Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve në vitin 2024 nga viti 2021 për mbështetjen e funksioneve të saj pasi Shoqëria është një nga anëtarët e saj. Këto paradhënie janë të arkëtueshme pasi kanë tejkaluar tarifat e anëtarësismit që i detyrohen Shoqërisë. Ato nuk konsiderohen të zhvlerësuara sepse Shoqëria pret të marrë shumën e plotë gjatë vitit 2025.

SIGAL UNIQA INVEST
Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024
(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

14. Llogari të pagueshme

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Detyrime ndaj furnitorëve	734	2,478
Totali	734	2,478

15. Llogari të pagueshme të tjera

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	1,941	8,118
Detyrimet ndaj AMF-së për tarifën tremujore	294	567
Detyrimet ndaj agjentëve për komisione	-	2,308
Detyrime të tjera	1,100	1,275
Detyrimet për paga dhe shpërblime	22	1,540
Totali	3,357	13,808

16. Kapitali aksionar

Struktura aksionare më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është si më poshtë:

31 Dhjetor 2024				31 Dhjetor 2023			
	%	Nr. i aksioneve	Ekivalent në lek	%	Nr. i aksioneve	Ekivalent në lek	
Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A.	51	24,237	29,084,688	51	24,237	29,084,688	
Z. Avni Ponari	49	23,287	27,944,112	49	23,287	27,944,112	
Totali	100	47,524	57,028,800	100	47,524	57,028,800	

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Numri i aksioneve të autorizuar dhe të paguara plotësisht në fillim të periudhës	47,524	47,524
Numri i aksioneve të autorizuar dhe të paguara plotësisht në fund të periudhës	47,524	47,524

Sipas ligjit 76/2023, neni 10, pika 1, shoqëria administruese duhet të mbajë kapital të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në kohën e duhur dhe në çdo rrethanë ai duhet të jetë jo më pak se 15 800 mijë lekë në çdo kohë. Likuiditetet e disponueshme të shoqërisë duhet të investohen vetëm në aktive që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AMF. Në këtë masë, rregullorja e AMF-së nr. 154, datë 19 shtator 2024, kërkon që fondet të investohen në letra me vlerë që tregtohen në tregje të rregulluara ose bono thesari apo obligacione të Qeverisë Shqiptare ose titujt e borxhit të bankave dhe institucioneve financiare të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë. Këto të fundit deri 5% të aktiveve dhe jo më se 2% në një emetues të vetëm.

SIGAL UNIQA INVEST
Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive S.H.A.
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024
(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

17. Të ardhura nga administrimi i fondit

	2024	2023
Tarifa e administrimit	55,008	58,316
Tarifa për tërheqje të parakohshme	5,257	5,745
Totali	60,265	64,061

Gjatë vitit 2024, burimi i vetëm i të ardhurave nga tarifat e administrimit rrjedhin nga Fondi i Pensionit Privat "Sigal", Fondi i Pensionit Privat "Sigal Pro" dhe Sipërmarrja e Investimeve Kolektive "Sigal Invest". Tarifa e administrimit llogaritet në baza ditore si 1.5% e vlerës neto të aktiveve të secilit fond plus të njëjtën përqindje shtesë mbi atë tarifë për fondet e pensionit dhe 3% për fondin e investimit. Tarifat e tërheqjeve të parakohshme nga fondet e pensionit llogariten si përqindje e vlerës neto të aktiveve të kuotave të anëtarit (pa tatimin në burim) në ditën e tërheqjes. Kjo përqindje ndryshon nga 2% (nëse është kontribuar për më shumë se 20 vjet) në 15% (kur kontribuohet për pesë vjet).

18. Të ardhura nga interesi e të tjera

	2024	2023
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	3,072	2,113
Të ardhura nga interesat e depozitave	467	73
Të tjera	126	-
Totali	3,665	2,186

19. Shpenzime për personelin

	2024	2023
Shpenzime personeli	26,143	26,418
Sigurime shoqërore	2,967	2,990
Kontributet e përcaktuara të planit të pensionit	805	1,112
Sigurime shëndetësore	-	469
Totali	29,915	30,989

Numri total i punonjësve më 31 Dhjetor 2024 ishte 12 (2023: 14 punonjës).

20. Shpenzime administrative

	2024	2023
Tarifë depozitari	3,326	3,623
Shpenzime të Fondit të Pensionit	1,440	1,029
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	1,425	1,285
Taksa dhe tarifa	1,129	185
Shpenzime marketingu	1,097	863
Mirëmbajtja e softuerit kompjuterik	431	321
Komisione bankare	304	211
Qira	-	755
Të tjera	1,609	1,879
Total	10,761	10,151

Tarifa e depozitarit llogaritet në baza ditore si 0.15% e vlerës neto të aktiveve në administrim. Tarifa e AMF llogaritet në baza mujore si 0.05% e vlerës neto të aktiveve të administruara. Shpenzimet e tjera përbëhen nga kosto të ndryshme për mirëmbajtje, shërbime profesionale. Tarifat e auditimit për vitin 2024 arrijnë në 1,500 mijë lekë. Shërbimet jo audituese nuk janë ofruar nga auditori i jashtëm.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

21. Tatim mbi të ardhurat

Llogaritja vjetore e tatim fitimit është si më poshtë

	2024	2023
Tatim aktual mbi të ardhurat	2,242	2,754
	2,242	2,754

Rakordimi i shpenzimit të tatimit për vitin që mbaroi më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 paraqitet si më poshtë:

		2024		2023
Fitimi për periudhën		15,238		17,606
Tatim fitimi sipas normës së përqindjes vendore	15%	2,285	15%	2,641
Aktive tatimore të shtyra të panjohura		(43)		113
Shpenzimi për tatim fitimin e vitit		2,242		2,754

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit për vitin 2024 është 15% (2023: 15%). Deklaratat tatimore janë plotësuar për çdo vit por fitim-humbjet e deklaruarra për qëllime tatimore mbeten si parashikime derisa autoritetet tatimore kontrollojnë ato dhe regjistrimet e taksapaguesit dhe lëshohet një vlerësim final. Ligjet tatimore shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritet tatimore. Shpenzimet e palejuara për efekte tatimore paraqesin shpenzime të pambështetura me dokumentacionin përkatës apo shpenzime të konsideruara të panjohura të efekte fiskale.

Shoqëria nuk ka njohur një shumë prej 43 mijë lekësh (2023: 113 mijë lekësh) të përbërë nga detyrimi tatimor i shtyrë prej 745 mijë lekësh (2023: 1,118 mijë lekë) dhe aktivi i tatimit mbi të ardhurat e shtyrë prej 815 mijë lekësh (2023: 1,231 mijë lekë) të lidhura përkatësisht me aktivet e të drejtës së përdorimit dhe detyrimet e qirasë, pasi nuk e konsideroi ndikimin e tyre si domethënës.

22. Angazhime dhe detyrime të konstatuara

Ligjore

Në mjedhën normale të veprimtarisë Shoqëria merr pretendime ligjore nga palë të ndryshme. Në datën e raportimit shoqëria nuk ka regjistruar ndonjë pretendim të tillë.

Angazhime

Shoqëria nuk ka zotime për shpenzime kapitale apo angazhime të tjera më 31 dhjetor 2024.

23. Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen në përgjithësi të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontrolli të përbashkët ose në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm ose kontrolli të përbashkët mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale. Duke marrë parasysh çdo marrëdhënie me palët e lidhura të mundshme, fokusi është drejtuar drejt substancës së marrëdhënies dhe jo formës juridike.

SIGAL UNIQA INVEST

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

23. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Palët e lidhura me të cilat Shoqëria ka pasur transaksione janë të shënuara më poshtë:

Palë e lidhur	Marrëdhënia
Sigal Uniqa Group Austria SH.A.	Shoqëria mëmë e grupit në Shqipëri
Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A.	Shoqëria mëmë
Fondi Vullnetar i Pensioneve Sigal	Fondi i cili menaxhon
Fondi Vullnetar i Pensioneve Pro	Fondi i cili menaxhon
Fondi i Investimeve Sigal Invest	Fondi i cili menaxhon
Avni Ponari	Aksionar
Elvis Ponari	Drejtor i përgjithshëm

Gjatë vitit Shoqëria ka pasur këto transaksione me palët e lidhura:

	2024	2023
Qira :		
Shpenzime për qira		
Sigal Uniqa Group Austria	3,169	3,397
Detyrime për:		
Sigal Uniqa Group Austria	1,941	8,118
Tarifa e administrimit		
Te ardhura nga		
Fondi i Pensionit "Sigal"	54,854	58,316
Fondi i Pensionit "Sigal Pro"	90	1
Fondi i Investimit "Sigal Invest"	65	-
Te arkëtueshme nga:		
Fondi i Pensionit "Sigal"	3,984	5,178
Fondi i Pensionit "Sigal Pro"	25	1
Fondi i Investimit "Sigal Invest"	7	-

Tarifa e tërheqjeve të parakohshme	2024	2023
Fondi i Pensionit "Sigal"	5,252	5,745
Fondi i Pensionit "Sigal Pro"	5	-

Tabela në vijim paraqet informacionin për aktivet neto nën administrim, të cilat Shoqëria administron por nuk konsolidon pasi ato nuk janë të kontrolluara prej Shoqërisë por prej anëtarëve të tyre.

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Fondi i Pensionit "Sigal"	3,157,492	2,789,451
Fondi i Pensionit "Sigal Pro"	20,261	784
Fondi i Investimit "Sigal Invest"	2,679	-
	3,180,432	2,790,235

Fondi i Pensioni SIGAL

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

- Pasqyra e Aktiveve të Fondit 31.12.2024

AKTIVET	Lek	Lek
	Periodha e meparshme 31.12.2023	Periodha aktuale 31.12.2024
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	70,880,878	36,928,963
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	2,662,341,286	3,053,211,582
Të tjera llogari të arkëtueshme	56,228,888	67,350,969
Totali i Aktiveve	2,789,451,052	3,157,491,514
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	5,178,146	3,984,034
Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë	1,819,533	2,044,562
TOTALI I DETYRIMEVE	6,997,679	6,028,595
AKTIVET NETO TË FONDIT	2,782,453,373	3,151,462,918
Numri i kuotave të emetuara të fondit	1,682,700	1,829,812
Aktivet Neto për Kuotë	1,654	1,722

• Pasqyra e Veprimtarisë 31.12.2024

Zerat e Aktivit	Lek	Lek
	Periudha meparshme 31.12.2023	Periudha Aktuale 31.12.2024
Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në tituj	12,956.050	21,927.760
Të ardhura nga interesat	167,684,189.490	198,353,345.050
Të ardhura nga interesa depozita bankare	811,327.500	823,274.980
TOTALI të Ardhura	168,508,473.040	199,198,547.790
Tarifa për shoqërinë administruese	58,315,119.980	54,852,901.050
Amortizimi aktiveve me afat maturimi fiks	18,437,436.540	(23,569,581.330)
TOTALI Shpenzime	76,752,556.520	31,283,319.720
Fitimi Realizuar i Fondit	91,755,916.520	120,776,065.410

• Pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto 31.12.2024

	Periudha e meparshme 31.12.2023	Periudha aktuale 31.12.2024
AKTIVET NETO në fillim të periudhës	2,487,072,572	2,782,453,373
Kontribute të kryera gjatë vitit	411,290,945	440,427,412
Tërheqje të kontributeve	(207,666,061)	(192,193,931)
RRITJA në aktivet e Fondit	203,624,884	248,233,480
Kuota të pensionit të emetuara	253,344.6515	261,014.7802
Kuota të Tërhequra nga anëtarët Fondit	(127,657.2730)	(113,903.1648)
Rritje në numrin e kuotave të fondit	125,687.3785	147,111.6154

Fondi i Pensioni SIGAL PRO

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

- Pasqyra e Aktiveve të Fondit 31.12.2024

AKTIVET	Lek	Lek
	Periudha e meparshme 31.12.2023	Periudha aktuale 31.12.2024
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	783,759	414,735
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	0	19,613,563
Të tjera llogari të arkëtueshme	0	232,366
Totali i Aktiveve	783,759	20,260,665
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	1,164	21,483
Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë	0	0
TOTALI I DETYRIMEVE	1,164	21,483
AKTIVET NETO TË FONDIT	782,595	20,239,181
Numri i kuotave të emetuara të fondit	785.4216	19,780.7195
Aktivneto për Kuotë	996.4008	1,023.1772

• Pasqyra e Veprimtarisë 31.12.2024

Zerat e Aktivit	Lek	Lek
	Periodha meparshme 31.12.2023	Periodha Aktuale 31.12.2024
Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në tituj	-	-
Të ardhura nga interesat	-	316,130.000
Të ardhura nga interesa depozita bankare	-	5,140.000
TOTALI të Ardhura	-	321,270.000
Tarifa për shoqërinë administruese	1,181.530	89,714.980
Amortizimi aktiveve me afat maturimi fiks	-	(71,170.400)
TOTALI Shpenzime	1,182	18,545
Fitimi Realizuar i Fondit	(1,182)	160,385

• Pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto 31.12.2024

	Periodha e meparshme 31.12.2023	Periodha aktuale 31.12.2024
AKTIVET NETO në fillim të periudhës	0	782,595
Kontribute të kryera gjatë vitit	783,776	19,326,399
Tërheqje të kontributeve	0	(30,197)
RRITJA në aktivet e Fondit	783,776	19,296,202
Kuota të pensionit të emetuara	785.4216	19,025.2893
Kuota të Tërhequra nga anëtarët Fondit	0.0000	(29.9914)
Rritje në numrin e kuotave të fondit	785.4216	18,995.2979

Fondi I Investimit SIGAL INVEST

- Pasqyra e Pozicionit Financiar (aseteve neto të fondit) 31.12.2024

Bilanci 2024	
Emërtimi	Vlera Leke
Mjete Monetare në llogari	258,156
Investime	2,369,732
Obligacione të Blera (treg primar)	687,955
Obligacione të Blera (treg sekondar)	1,681,777
Llogari te arketueshme	51,511
Shuma Aktivi	2,679,398
Detyrime të Fondit	7,318
Ndaj Shoqerisë Administruese	6,797
Ndaj depozitarit	408
Ndaj AMF	113
Aktivet Neto të fondit	2,672,080
Shuma Pasivi	2,679,398

- Pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve 31.12.2024

Pasqyra Te Ardhura - Shpenzime	
Te Ardhura	Vlera
Te Ardhura nga interesat obligacione	147,894
Te Ardhura nga interesat Depozita	0
Shuma Te Ardhura	147,894
Shpenzimet	Vlera
Tarifa per Shoqerine Administruese	65,485
Tarifa per Depozitarin	3,929
Tarifa AMF e shpenzime bankare	4,068
Rritje / Zvogelimi nga veprimtaria e fondit	74,412
Shuma Shpenzime	73,482
Fitimi (humbja) e perealizuar nga investimet në letra me vlerë,+/-	97,668
RRITJA (ZVOGËLIMI) I ASETEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	172,080

Shoqeria në përgjithësi fondet e investuara nga anetaret e saj, i ka përdorur në blerje obligacione të Shtetit Shqiptar, emetuar nga Banka e Shqipërisë në ankandet e organizuara prej saj. Gjendja aktuale në fund të vitit 2024 për obligacionet e blera sipas afateve është si më poshtë:

Obligacionet			
Emertimi	Vlera nominale	Shpenzime blerje	Vlera Dt. Raport
Obligacione afat 7 vjeçar	200,000	197,718	202,589
Obligacione afat 10 vjeçar	1,000,000	1,082,576	1,009,014
Obligacione afat 15 vjeçar	1,000,000	991,769	1,158,128
Shuma	2,200,000	2,272,063	2,369,732

Bazuar në informacionet e mësipërme, Viti 2024 ishte një vit me performancë të qëndrueshme të fondeve të aepnsionit si dhe Fondit të investimit. Fondet e Pensionit Sigal dhe Sigal PRO vazhduan të ofrojnë kthime të qëndrueshme me rrezik shumë të ulët, duke përmbushur objektivin e tyre primar; ruajtjen dhe rritjen graduale të kursimeve të anëtarëve për një pension të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Nga ana tjetër Fondi i Investimit SIGAL INVEST tregoi një dinamikë më të lartë, duke reflektuar strategjinë e tij më aktive dhe profilin disi më të lartë të rrezikut, i përshtatshëm për investitorë që kërkojnë rritje më të lartë të kapitalit në afatmesëm dhe afatgjatë.

Të gjithë treguesit e rrezikut, kthimit dhe kohëzgjatjes janë monitoruar rregullisht dhe janë menaxhuar në përputhje me strategjinë e investimit dhe objektivat statutoare të fondeve. Përgjatë vitit 2024, menaxhimi profesional, transparenca dhe përkushtimi ndaj sigurisë së investimeve kanë mbetur në qendër të veprimtarisë tonë.

Duke parë përpara, synojmë të vijojmë me të njëjtin standart profesional, të zgjerojmë bazën e anëtarëve dhe të ofrojmë zgjidhje të përshtatura me nevojat në ndryshim të investitorëve tanë.

SIGAL UNIQA INVEST

RAPORTI VJETOR 2024

